



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Për shqyrtimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve të organeve drejtuese të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve”*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 28.09.2020, ora 14:00

**Drejton mbledhjen:**

**Damian Gjijnuri – kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar**

**Rendi i ditës**

Përcaktimi i axhendës së punës së komisionit.

**Marrin pjesë:**

Damian Gjijnuri, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Myslim Murrizi, Edmond Stojku dhe Oerd Bylykbashi.

**Mungojnë:**

## HAPET MBLEDHJA

**Damian Gjikhuri** – Mirdita të gjithëve!

Siç jeni njoftuar, kjo është mbledhja e komisionit përzgjedhës, siç e ka parashikuar Kodi Zgjedhor për anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në Kodin Zgjedhor është parashikuar një procedurë e posaçme që parashikohet në nenin 183, e cila është dispozitë kalimtare. Unë po them dy-tri gjëra se çfarë presupozon kjo procedurë. Pra, anëtarët rregullatorë dhe anëtarët e KAS-it zgjidhen për herë të parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji në bashkëveprim me partitë parlamentare të dala nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. Pra, këtu kemi edhe përfaqësuesin e Partisë Demokratike, zotin Bylykbashi, të cilit i urojmë mirëseardhjen, që është pjesë integrale e procesit përzgjedhës.

Si funksionon ky komision? Ne, pesë anëtarë, përfaqësuesit e Kuvendit për komisionerin përzgjedhim nga lista 3 kandidatura që ne e gjykojmë të përshtatshme dhe përfaqësuesi i Partisë Demokratike eliminon një emër dhe dy emrat votohen në seancën e Kuvendit.

Së dyti, për nënkryetar, përfaqësuesi i Partisë Demokratike përzgjedh nga lista 3 emra dhe një emër eliminohet nga ana jonë dhe ato i shkojnë për votim seancës së Kuvendit.

Ndërsa për pjesën e komisionerëve rregullatorë përzgjidhen 3 emra nga përfaqësuesit e Kuvendit dhe dy emra nga përfaqësuesit e posaçëm të opozitës jashtëparlamentare, e njëjta gjë bëhet edhe me KAS-in, dhe 5 emrat shkojnë në bllok për votim në seancën plenare.

Unë i thashë stafit të Kuvendit të bëjë një pasqyrë të të gjithë dokumentacionit të kandidatëve dhe të shikojë se kush nuk i plotëson kriteret, që ne të marrim një vendim.

Hapi i dytë, nesër dhe pasnesër do të kryejmë disa seanca dëgjimore *online* me të gjithë aplikantët.

Në fund do të bëjmë mbledhjen për të kryer procedurën e përzgjedhjes në një ditë që do ta vendosim ne, mundësisht para seancës plenare, në mënyrë që ta përfundojmë sa më shpejt këtë proces. A jeni dakord të vazhdojmë me këtë procedurë? Nga ana procedurale, a ka...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, do të mundohemi ta mbyllim këtë javë, pra javës tjetër i bie që ta votojmë.

**Oerd Bylykbashi** – Meqenëse e enjtja tjetër është shumë larg në raport me ngritjen e KQZ-së, e cila ka edhe procedura më pas, a ekziston mundësia që parlamenti të zhvillojë seancë më herët?

**Damian Gjikhuri** – Nuk e di, por ne do të vazhdojmë edhe nesër...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë mendoj që një ditë përpara seancës së Kuvendit duhet ta mbyllim si proces. Ai është një proces formal dhe ne duhet vetëm të çojmë emrat. Prandaj, me lejen tuaj, stafi të na bëjë një prezantim në lidhje me aplikimet, për të parë se ku jemi.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, jo, ne do të bëjmë seancë dëgjimore për këtë, por po them nga ana e dokumentacionit. Aty keni një raport, nga i cili të theksohet se kush nga këta...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Seanca dëgjimore do të zhvillohet, sepse është procedurë parlamentare.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Këta jo.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Dakord. Kjo është ideja. Sot do të bëjmë filtrin e parë dhe në mbledhjen e fundit bëjmë filtrin e fundit.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Këtë po them.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Myslim, të lutem, sot do të bëjmë filtrin e parë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jo është me votim të thjeshtë këtë radhë, sepse është dispozitë kalimtare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, pra ne do të bëjmë filtrin e parë, për të parë se kush i plotëson kriteret, që t'i heqim të tjerët dhe të mos i thërrasim nesër ose pasnesër. Pastaj do të bëjmë mbledhjen e fundit, ku do të marrim vendimet.

Merita, na bëj një prezantim shkurt.

**Merita Qato** – Përshëndetje!

Në bazë të njoftimit që është bërë në faqen zyrtare për të paraqitur aplikimet, kanë paraqitur kërkesat e tyre: 26 aplikantë për komisionerë, 15 aplikantë për nënkomisionerë, 47 aplikantë për anëtarë të Komisionit Rregullator dhe 48 aplikantë për KAS-in. Në bazë të këtyre aplikimeve, ne kemi bërë edhe ndarjen sipas kërkesave që ata kanë paraqitur dhe në çdo dosje është bërë edhe inventari i dokumentacionit që ata kanë dorëzuar.

Ndërkohë, ne kemi bërë edhe vlerësimin e çdo kandidati, në bazë të kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Në tabelat që ju keni përpara është çdo aplikim i paraqitur, duke filluar nga komisionerët, ku kemi vendosur kriteret që ata plotësojnë sipas Kodit Zgjedhor

dhe kriteret ndaluese në ato raste kur Kodi e ka të përcaktuar. Faktikisht ju i keni në dispozicion të gjitha formatet e aplikimeve, ku janë përcaktuar kandidatët për komisionerë, për nënkomisionerë dhe kandidatët për Komisionin Rregullator. Ne i kemi vendosur aty ku ka kriteret ndaluese çdo kandidat, duke u mbështetur kryesisht në CV-të që ata kanë paraqitur dhe në dokumentacionin që disponohet në dosje. Në bazë të CV-ve të tyre, ne kemi renditur kriteret që ata plotësojnë, si dhe kriteret ndaluese, pastaj vlerësimi për çdo kandidat është pjesë e komisionit sipas këtij formati, të cilën e keni edhe ju përpara.

**Myslim Murrizi** – A e keni parë ju nëse ka individë, të cilët kanë aplikuar për tri drejtime njëkohësisht?

**Merita Qato** – Po, ka. Në qoftë se kemi gjithsej 70 aplikantë, numri i përgjithshëm i aplikimeve shkon 120, sepse ka aplikantë që kanë paraqitur kërkesat e tyre për 4 poste, ka aplikantë që kanë paraqitur kërkesat për 3 poste dhe ka aplikantë që kanë paraqitur kërkesat për 2 poste.

**Myslim Murrizi** – Domethënë janë 70 individë...

**Merita Qato** – Pra, si numër janë gjithsej 70.

**Myslim Murrizi** – Pra, gjithsej janë 70?

**Merita Qato** – Po, gjithsej janë 70.

**Myslim Murrizi** – Në rregull!

**Merita Qato** – Gjithsej janë 70 kandidatë që kanë aplikuar për dy apo më shumë poste, për shembull për Komisionin Rregullator dhe KAS-in...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Domethënë, për efekt dëgjese janë 70 aplikantë gjithsej.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kriteret në Kod nuk janë të përcaktuara në mënyrë specifike, domethënë që të jetë jurist, të ketë kaq vjetërsi e të tjera, sepse janë kriteret të përgjithshme, ndaj janë të paktën 20 kandidatë, të cilët nuk i plotësojnë fare kriteret për sa i përket Komisioni Rregullator, sepse rregullatori kërkon që kandidati të ketë eksperiencë në fushën e hartimit të ligjeve dhe të ketë marrë pjesë në procese ligjvënëse. Për shembull, shumica e atyre që kanë aplikuar kanë punuar vetëm si përkthyes, disa të tjerë kanë punuar vetëm si avokatë dhe në Komisionin Rregullator nuk pranohen, sepse nuk i plotësojnë kriteret. Pra, mund të jenë afërsisht 20 veta, të cilët mund të mos i plotësojnë kriteret nga vlerësimi që ne kemi bërë, por gjithmonë është vlerësimi juaj ai që do t'i gjykojë në fund.

**Damian Gjikhuri** – Le t'i marrim me radhë. Pra, emri i parë te lista e kandidatëve është Admir Drago, kandidat për komisioner, i cili nuk ka kriter ndalues.

**Merita Qato** – Nuk ka kriter ndalues, është ish –funksionar politik.

**Damian Gjikhuri** – Pra, do të thirret për dëgjim, filtri i parë.

Kandidati tjetër është Agron Haxhimali, i cili ka kriter ndalues, pasi aktualisht është drejtor dhe ligji e ka që duhet të jetë “ish”, në mos gaboj.

**Merita Qato** – Po.

**Damian Gjikhuri** – Pra, edhe ky i bie, në qoftë se edhe ju nuk do të keni kundërshtim...

**Merita Qato** – Ky është për komisioner ...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Damian Gjikhuri** – Atëherë, një minutë, ligji e ka...

**Merita Qato** – Në qoftë se ne do të lexojmë se çfarë thotë ligji për komisionerin...

**Damian Gjikhuri** – Po, lexojeni ligjin.

**Merita Qato** – Ligji thotë :“Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që vjen nga radhët e ish-funksionarëve politikë apo të kabineteve, ish-nëpunësve të nivelit të lartë drejtues, ose ish-drejtuesve të organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtave të njeriut. Përzgjedhja e Komisionerit bëhet në bazë të eksperiencës së mëparshme të suksesshme në drejtim, të ligjshmërisë së demonstruar ose të provuar në ushtrimin e detyrës”. Pra, këto janë ...

**Damian Gjikhuri** – Ky aktualisht është drejtor.

Ligji thotë: “...-ish drejtues të organizatave joqeveritare që merren me zgjedhjet”. Pra, aktualisht ky është drejtor ekzekutiv, që do të thotë se është në një funksion dhe nuk mund të aplikojë. Pra, ata që janë aktualisht drejtorë ekzekutivë nuk mund të aplikojnë. Kjo është në ligj dhe, për mua, edhe zoti Haxhimali duhet të s’kualifikohet.

**Merita Qato** – Prandaj, edhe ne i kemi bërë një shënim me letër të verdhë, sepse faktikisht ai është drejtor.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Jo, e ke të përcaktuar dhe thotë: “... mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që vjen nga radhët e ish-funksioneve politike apo të kabineteve, ish-nëpunës të nivelit të lartë drejtues, ose ish-drejtues të organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtave të njeriut. Përzgjedhja në komision bëhet në bazë të eksperiencave të mëparshme të suksesshme, në drejtim të ligjshmërisë të demonstruar, ose provuar në ushtrimin e detyrave, apo funksioneve dhe reputacionit publik të kandidatit. Dokumentet, apo referencat provuese të kandidatit për suksesin në ligjshmërinë në ushtrimin e detyrës duhet të shtrihen për një periudhë të vazhdueshme 3-vjeçare. Nënkomisioni ka efekte të tjera, të cilat janë tek anëtari i Komisionit Rregullator dhe i KAS-it, që thotë që nuk duhet të ketë përvojë në administratë.

Këto janë të shkëputura nga ligji.

**Damian Gjikhuri** – Për mua si të doni. A doni ta kalojmë?

Oerd, si do? Do që ta kalojmë?

Dakord.

Le të thirret në seancë Agron Haxhimali, një më shumë nuk na prish punë.

Anton Lleshaj....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kalon pra për t'u thirrur ne intervistë, pra Admiri kalon, Haxhimali kalon, Lleshaj nuk kalon, sepse nuk ka përvojë, është funksionar politik, nëpunës i nivelit të lartë, por nuk ka eksperiencën e nevojshme administrative. A jeni dakord?

Skualifikohet.

Arben Xhiku, ish-nëpunës i lartë, drejtor i përgjithshëm. Këtë e kam larguar unë.

Ardian Myslimaj, ish-deputet, kualifikohet.

Bledar Skënderi a ka pengesë?

**Merita Qato** – Problemi është se Bledar Skënderi tani ka dhënë dorëheqjen, domethënë 2 ditë përpara se dorëzonte kërkesën, ka bërë aplikimin.

**Damian Gjikhuri** – Pra ka dhënë dorëheqjen!

**Merita Qato** – Po.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e pengon njeri, se ka dhënë dorëheqjen.

**Damian Gjikhuri** – Atëherë Bledar Skënderi, kualifikohet.

Drita Abdyli kalon.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Myslim, me radhë, të lutem! Jemi te Bledar Skënderi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

T'i them unë me radhë, Dritan Çaka është ish-funksionar politik kabineti, Drejtor Kabineti në OST, këshilltar. As ky nuk ka pengesë.

Hakim Mustafa, partia jote, Myslim, ta kalojmë? Dakord, nuk ka pengesë. Pra Abdyli kalon, Caka kalon, Mustafa kalon, Halil Hyseni ish-funksionar kalon, Helga Vukaj, ish-ministre, kalon, Hysen Osmanaj, ish-KQZ-së kalon. Ilirjan Celibashi, ish-kryetar KQZ-së kalon, Ilir Rusmaili kalon. Irsa Ruxhi, kjo është liruar nga detyra, a ka pengesë ligji, apo shkelje?

**Merita Qato** – Jo, nëse është liruar nga detyra nuk ka pengesë.

**Damian Gjikhuri** – Dakord, Irsa kalon.

Ismali Tafani është në rregull, Koli Bele kalon, Lealba Pellingu nuk ka pengesë, Muharrem Çakaj nuk ka pengesë, kalon, Naim Meçalla nuk ka të dhëna në ushtrim, ish-oficer sigurimi...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Atëherë nuk kalon.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pra, Naim Meçalla nuk ka dokumentacion përkatës. Nuk kalon.

Olimbia nuk rezulton të ketë përvojë si funksionare, pra as kjo nuk plotëson kriteret që ka ligji. Nuk kalon.

**Merita Qato** - Përparim Shullazi është nga Partia e Paraplegjikëve dhe e ka propozuar partia si përfaqësues.

**Damian Gjikhuri** – Ndalohet. Iku edhe ky, nuk kalon.

Rudin Deda nuk rezulton të ketë pasur përvojë si funksionar politik apo drejtues OJF-je.

Edhe ky nuk i plotëson kriteret.

Sali Shehu kalon.

Sokol Banaj kalon.

**Merita Qato** – Sokoli ka qenë kryeregjistruar në Vlorë.

**Damian Gjikhuri** – Pedagog, zëvendësdekan.

**Merita Qato** – Ka dhënë dorëheqjen, nuk është shkarkuar.

Kemi Naim Meçallën si ish-punjonjës, kemi Olimbi Hoxhaj që nuk ka përvojë, kemi Përparim Shullazin, por që është anëtar i një partie dhe që është propozuar nga partia, kemi Rudin Deden që nuk rezulton të ketë pasur përvojë.

Këto janë.

Sokoli është okej.

**Damian Gjikhuri** – Atëherë, nga kandidatët për komisioner skualifikohen 5 dhe mbeten 21.

**Merita Qato** – Atëherë nga 26, 5 kanë ikur dhe 21 janë për t'u njoftuar. Këta mund t'i njoftojmë nesër që të mund të fillojmë me komisionerët.

Komisioneri dhe nënkomisioneri kriteret i kanë njësoj.

**Damian Gjikhuri** – Agron Haxhimali kalon, Arben Xhiku kalon, Elvis Çefa kalon, Haki Mustafa kalon, Hegla Vukaj kalon, Hysen Osmanaj kalon, Ismail Tafani kalon, Jona Kuka...

**Merita Qato** – Jona Kuka është vetëm përkthyesë dhe nuk ka asnjë përvojë. Ka marrë pjesë në OJF dhe është ekonomiste. Nuk kalon.

**Damian Gjikhuri** – Jona Kuka nuk kalon, Muharrem Çakaj kalon...

**Merita Qato** – Meçalla u skualifikua se ishte punonjës i Sigurimit të Shtetit.

**Damian Gjikhuri** – Naim Mëçalla ikën, Olimbi Hoxhaj ikën, Përparim Shullazi ikën, Rudin Deda ikën, Valbona Lasku ikën, edhe Jona Kuka që ishte përkthyesë ikën.

Dakord?

Atëherë, edhe Olimbi Hoxhaj, po.

**Merita Qato** - Valbona Lasku vetëm menaxheren ka si përvojë. Valbona Lasku ka qenë menaxhere e organizatave bamirëse.

**Damian Gjikhuri** – Hiqe!

**Merita Qato** – Tre, katër, gjashtë, tetë. Tetë.

**Damian Gjikhuri** – Je dakord, Oerd, me këto emra që hoqëm?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Merita Qato** – Një minutë! Prit, pra, t'i themi! Prisni një minutë, ju lutem!

Atëherë, përfundimisht, nga lista e nënkomisionerëve është Jona Kuka, Naim Mëçalla, Olimbi Hoxhaj, Përparim Shullazi, Rudina Dede dhe Valbona Lasku, që ikin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dy, tre, katër... Gjashtë ikin.

**Damian Gjikhuri** – Në rregull!

**Merita Qato** – Gjashtë ikin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, që të mbarojmë.

Një minutë! Jona është një, është Naim Mëçalla dy, Olimbi Hoxhaj tre, Përparim Shullazi katër, Rudin Deda pesë dhe Valbona Lasku gjashtë.

**Damian Gjikhuri** – Në rregull! Ju lutem, vazhdojmë! Tashti komisionerë rregullatorë.

**Merita Qato** – Atëherë, a mund t'i lexojmë kriteret për Komisionin Rregullator?

**Damian Gjikhuri** – Po.

**Merita Qato** – Mund të zgjidhen shtetas që vijnë nga radhët e ish-funksionarëve politikë apo të kabinetëve, ish nëpunës të nivelit të lartë drejtues ose ish-drejtues të organeve jofitimprurëse, me veprimtari në këtë fushë. Përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit Rregullator bëhet në bazë të eksperiencave të mëparshme, të suksesshme në hartimin, shqyrtimin ose në oponencën e ligjshmërisë, të demonstruar, të provuar në ushtrimin e detyrave, funksioneve apo



të reputacionit publik të kandidatit. Dokumentet apo referencat provuese të kandidatëve për suksesin dhe ligjshmërinë, duhet të shtrihen së paku për një periudhë vazhduese trevjeçare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më falni!

**Damian Gjiknuri** – Ju lutem!

**Merita Qato** – Këtu rregullatori bëhet në bazë të eksperiencës së mëparshme në hartimin, shqyrtimin dhe oponencës së legjislacionit.

**Damian Gjiknuri** – Në rregull!

**Merita Qato** – Kjo është diçka e re.

**Damian Gjiknuri** – E kuptova.

Atëherë, ju lutem, le të fillojmë!

Admir Drago, ish funksionar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

I lejon, i lejon.

Drago i plotëson kushtet.

**Merita Qato** – Nuk ka kriter ndalues. Ka qenë ish-këshilltar në kabinetin e Kryeministrit, çka do të thotë se ka marrë pjesë edhe në hartimin...

**Damian Gjiknuri** – Në politikëbërje. Po.

Paskali nuk ka paraqitur ndonjë deklaratë, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion, sepse është anëtar ekipi i një partie politike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, hiqe!

**Merita Qato** – Atëherë, Agim Paskali?

**Damian Gjiknuri** – Paskali ikën.

**Merita Qato** – Ikën Paskali, në rregull!

**Damian Gjiknuri** – Agron Haxhimali ikën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Merita Qato** – Më falni, e lamë ok te komisioneri.

**Damian Gjiknuri** – Po pra, Haxhimali ok!

**Merita Qato** – Te komisioneri. Po prisni, se këtu kemi një kriter tjetër: a ka eksperiencë në legjislativ?

**Damian Gjiknuri** – Eksperiencë legjislative. Hiqe!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Merita Qato** – Albi Gjenerali.

**Damian Gjikhuri** – Nuk plotëson kriteret.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një minutë! Konstatohet se kandidati nuk rezulton të plotësojë kushtet... Çfarë është kjo? Po, s'ka trevjetëshin, po.

**Merita Qato** – S'ka trevjetëshin, prandaj.

**Damian Gjikhuri** – Po, në rregull! Arben Xhiku kalon. Arens Çela kalon.

**Merita Qato** – Ka qenë dhe asistent...

**Damian Gjikhuri** – Artan Syziu.

**Merita Qato** – Artan Syziu vazhdon punën në Ministrinë e Drejtësisë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Përgjegjës sektori është.

**Damian Gjikhuri** – Nuk do të thotë gjë ajo.

**Merita Qato** – Prit! Është përgjegjës sektori në ministri.

**Damian Gjikhuri** – Jo, ka të drejtë, ish nëpunës i lartë, por edhe juristë që kanë eksperiencë.

Më fal, është në funksion ky?

**Merita Qato** – Është në funksion.

Me zotin Artan Syziu, si do t'ia bëjmë?

**Damian Gjikhuri** – Jo, do ta thërrasim në intervistë.

Artan Kodheli, iku.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Merita Qato** - Anjeza Dajzmaili, është thjesht pedagoge në fushën e drejtësisë dhe nuk ka asnjë përvojë tjetër.

**Damian Gjikhuri** – Anjeza ikën.

Behar Zeneli, kalon, është në rregull, ndërsa Artan Kodheli ikën.

**Adnor Shameti** – Kisha një sugjerim që të gjitha këto na i përmblihdni, sepse kur të flasë një person që është në 3-4 vende vetëm 2 minuta duhet të ketë në dispozicion.

**Damian Gjikhuri** – Një herë do t'i thërrasim.

**Merita Qato** – A mund t'ju them diçka.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Sa i takon pjesës së njoftimeve, për t'ju sqaruar diçka, ne kemi bërë listën e kandidatëve ku kemi nxjerrë adresat e *e-mail*-et dhe numrat e telefonave. Ata persona, të cilët do të kualifikohen, do të njoftohen për dëgjuesë me minutazhin që mund të vendosni ju, jo më shumë se 5 minuta.

*(Diskutime pa mikrofon)*

3 minuta. Në rregull.

Drita Avdyli.

**Damian Gjikhuri** – Durim Grabova, nuk kalon.

**Myslim Murrizi** – Çfarë ka që nuk kalon?

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Eldrina Karafili. Edhe kjo ikën.

Elona Bano, ish-shefe kabineti, eksperte e jashtme në Kuvend për reformën në drejtësi.

Elona Bano, ka qenë shefe kabineti e zotit Majko.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ervin Lako, në rregull.

**Merita Qato** – Është në rregull se ka përvojën.

Elvis Çefa, në rregull.

**Damian Gjikhuri** - Elvin Lako, është në rregull, sepse ka eksperiencë, është i vjetër.

**Merita Qato** – Emiliano Braho.

**Damian Gjikhuri** – Emiliano Braho, nuk i plotëson kriteret.

Na lini të dëgjojmë.

**Merita Qato** – Emiliano Braho, ka punuar si avokat dhe për një farë kohe si përgjegjës Sektorit të Zyra Qendrore e Regjistrimit dhe tani vazhdon avokat.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Pra kalon? I plotëson apo jo?

**Merita Qato** - E njeh zoti Adnor.

Emiljano.

**Damian Gjikhuri** – Nëse nuk i plotëson, lëreni.

Atëherë Emiliano Brahon, si do ta vendosim? Nuk kalon. Nuk ka eksperiencë në ligjvënie.

**Merita Qato** – Nuk ka qenë ish-funksionar.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Nuk e ka në CV.

**Damian Gjikhuri** – Myslim, nuk kemi gjë me atë. Ajo thotë nuk ka eksperiencë në hartimin e legjisllacionit, do të thotë të kesh punuar në institucione shtetërore. Ky nuk ka eksperiencë të tillë dhe bie.

Helga Vukaj, Hysen Osmanaj, Ilirjana Nano. Çka është ky pozicion aktual?

**Merita Qato** – Ilirjana Nano nuk e ka shkruar nëse e vazhdon punën ose jo.

**Damin Gjikhuri** - E thërrasim Ilirjanën dhe e pyesim.

Irsa Ruçi, dakord.

Iva Nathanaili. Ku ka qenë kjo? Qenka e periudhës së Oerdit.

**Merita Qato** – Iva Nathanaili tani punon avokate, ka qenë në Ministrinë e Shtetit në vitet...

**Damian Gjikhuri** – Në vitet 2011 e në vazhdim... Eksperiencë si këshilltare për hartime ligjesh ka?

**Merita Qato** - Iva Nathanaili deri në vitin 2016 ka qenë në ministri, nga viti 2016 deri tani punon avokate e lirë.

**Damian Gjikhuri** – Iva Nathanaili kalon. Jona Kuka nuk kalon.

Kamerion Salillari. Ky nuk ka eksperiencë, hiqe.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

**Merita Qato** – Vetëm këto ka paraqitur. Klement Zguri.

**Damian Gjikhuri** - Klement Zguri ok. Kristaq Kume. Kristaqin do ta thërrasim. Nuk ka dokumentacion për deklaram. Aty do ta pyesim, a ka konflikt interesi.

**Merita Qato** – Laureta Bregasi.

**Damian Gjikhuri** - Laureta Bregasi kalon.

Lealba Pelinku, kalon.

**Damian Gjikhuri** - Lefteri Luzi kalon.

Ju lutem, një saktësim, aty ku thotë që mungon deklaratë, e sqarojmë në pyetje përgjigje, se mos ta djegim tjetrin.

Të tjerët nuk i lamë për deklaratë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Alket Hyseni** – Kur nuk plotëson as pesë letra që ka votimi, nuk mund të vlejë më tepër.

*(Diskutime në sallë.)*

**Merita Qato** – Tek të tjerat nuk kemi bërë përjashtim për mungesë dokumentacioni.

**Damian Gjikhuri** – Nuk kemi hequr rast për deklaram, madje e futëm. Atëherë, edhe Laureta Bregasi e ka këtë të deklaramit, edhe Leonard Gremshi po ashtu. Këta do t'i sqarojmë dhe më pas do ta vendosim ne.

*(Diskutime në sallë.)*

Lindita Tako, kalon.

**Merita Qato** – Kalon, sepse i japim shansin ta dëgjojmë për mungesën e këtij dokumentacioni.

Lindita Tako është avokate për momentin. Ka qenë në Komitetin e Zhvillimit të Turizmit dhe ka eksperiencë.

Naim Mëçalla nuk kalon.

**Adnor Shameti** – Kam një pyetje: pse është ish-oficer i shërbimit...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Merita Qato** – Ai ka shkruar në CV se ka qenë oficer i sigurimit deri në vitin 1985.

*(Zoti Murrizi diskuton pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Odeta Berberi kalon. Pavlina Docaj kalon. Perparim Shullazi është anëtar aktiv i një partie dhe nuk kalon.

*(Diskutime.)*

Si ta vendosni ju. Doni që ta heqim Pavlinën? E hoqëm.

Rudin Deda e hoqëm.

Sokol Bana kalon, se ka qenë edhe zëvendësdekan i Fakultetit Juridik.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Spiro Kristo Maliqi... Këtë do ta pyesim.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Edhe Theodhori Sollaku, po. Do të thirret.

Nuk ka paraqitur deklaratën. Do ta sqarojmë dhe duhet të dorëzojë deklaratën.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, kjo duhet të ikë. Nuk ka eksperiencë në bërje ligjesh Lasku, ikën.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Valbona Lasku ikën dhe Xhafer Seiti, inxhinieri, ikën.

*(Diskutime pa mikrofon)...*

**Oerd Bylykbashi** – Ka diçka, për shembull, marrim rastin e Agron Haxhimalit. Është përjashtuar nga kjo, por është diku tjetër.

**Damian Gjikhuri** – Dihet ajo.

**Oerd Bylykbashi** – Për efekt të seancës dëgjimore...

**Damian Gjikhuri** – Patjetër.

**Oerd Bylykbashi** – Ajo do të dëgjohet. Do t'i notifikohet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një herë do të flasim për të gjitha.

**Alket Hyseni** – Po, do të shënohet aty që keni aplikuar dhe jeni kualifikuar.

**Oerd Bylykbashi** – Pra, duhet të njoftohet se për çfarë kualifikohet.

**Merita Qato** – Po, po, do t'i njoftojmë ne, se i kemi bërë me listë.

**Damian Gjikhuri** – Dëgjo, për mua njoftimet bëjini pasi të mbyllim këtë.

**Merita Qato** – Po, po, pasi të mbyllet.

**Damian Gjikhuri** – Por edhe njoftimi të bëhet që sot për të gjithë.

**Merita Qato** – Po, po, që sot do t'i bëjmë.

**Damian Gjikhuri** – U skualifikuan këta, kanë ngelur këta; ta dinë njerëzit.

Mirë?

*(Deputeti Murrizi flet pa mikrofon.)*

**Merita Qato** – Po pra, njoftimi do të bëhet sot edhe për sa janë larguar, edhe kush do të jetë...

**Damian Gjikhuri** – Ata që kalojnë, aty ku kalojnë. Dhe e dinë për çfarë do të vijnë.

**Oerd Bylykbashi** – Por sipas çdo pozicioni.

**Merita Qato** – Po, sipas çdo pozicioni.

Edhe diçka tjetër, të lutem: 14-ën, 19-ën. Durim Grabova dhe Emiliano Braho.

**Damian Gjikhuri** – Po, po.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Merita Qato** – Jo, unë dua të jem e saktë, se nesër i nxjerr unë atje. Jo, më mirë të jem në rregull për vete...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Vazhdojmë me KAS-in tani, të lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Merita Qato** – Atëherë, Admir Drago. Ku e kemi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kemi kaluar. Atëherë, është e nevojshme...

**Damian Gjikhuri** – Fillojmë me KAS-in.

**Merita Qato** – A është e nevojshme që të lexoj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Ja, po e bëjmë me radhë që ta normoj.

Admir Drago?

**Merita Qato** – Të lexoj kriteret.

**Damian Gjikhuri** – Po, kriteret ndaluese.

**Merita Qato** – Atëherë, mund të zgjidhesh shtetas shqiptar që vjen nga radhët e ish-gjyqtarëve, ish-këshilltarëve në Gjykatën Kushtetuese ose në Gjykatën e Lartë, ish-anëtarë të KQZ-ve, ish-nëpunës të nivelit të lartë drejtues ose të juristit në profesionin e lirë me përvojë në gjykimet administrative.

**Oerd Bylykbashi** – Që do të thotë edhe avokatët.

**Merita Qato** – Po, avokatë, sidomos në fushën e të drejtës civile.

**Oerd Bylykbashi** – Po të të kujtohet, ne e futëm te kriteret, e zgjeruam.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Merita Qato** – Jo.

**Oerd Bylykbashi** – Ata do t'i lëmë të vdesin për bukë.

**Merita Qato** – Kanë pengesë në ligjin e tyre.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ligji i vetingut thotë që nuk kanë të drejtë të punojnë për caq vite në punë në asnjë nga organet e shtetit. Kështu që është kriter pengues në ligjin e tyre.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Përzgjedhja e anëtarit...

**Damian Gjikhuri** – T'i marrim me radhë. Për Admir Dragon thamë okej; kalon.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Prit, kandidati nuk ka paraqitur një deklaratë; do të thirret.

*(Deputeti Hyseni flet pa mikrofon.)*

Jo, nuk është...

**Merita Qato** – Agim Paskali.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jo, e kemi kaluar.

**Damian Gjikhuri** – Ka kriteret të tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Merita Qato** – E kemi kaluar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – E kaluam. Të lutem!

Vazhdojmë me zotin Agron Sulshabanaj.

**Merita Qato** – Edhe ky nuk ka paraqitur, por është avokat.

**Damian Gjikhuri** – Nuk ka vetëdeklarim.

*(Deputeti Murrizi ndërhyr pa mikrofon.)*

**Merita Qato** – Nuk ka vetëm deklaratën, por ka përvojën...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po pra, atë po them, ka përvojë në gjykime administrative; kalon.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kalon, sepse ka përvojë në gjykime administrative.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Jo, jo, një minutë, të lutem!

Të kthehem pak përpara. Ky është ekonomist, nuk e di pse është futur ky.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kandidati, drejtor Thesari. Hiqe këtë Agim Paskali. Aty duhen juristë me gjykim... Hiqe këtë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ke të drejtë!

**Merita Qato** – Prandaj edhe unë ju lexova kriteret, sepse është ankimimi dhe sanksionet.

**Damian Gjikhuri** – Merita, e kishit bërë, përveç kriterëve ndaluese...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Merita Qato** – Jo, më falni, te rregullatori nuk e kemi skualifikuar!

**Damian Gjikhuri** – Mos u mërzit, Alket, nuk ka faj ajo! Këtu po ngatërrohem edhe ne.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Merita Qato** – Jo, te rregullatori nuk e kemi skualifikuar.

**Damian Gjikhuri** – Ta drejtoj unë që të mbajmë pak rendin?

Pra, të lutem, Agim Paskali skualifikohet, sepse është ekonomist.

Zotin Agron Sulshabanaj do ta thërrasim, sepse ka vetëm mosdeklarim.

Okej është.

Albi Gjenerali, nuk kualifikohet, pasi nuk rezulton të plotësojë... Ikën Albi Gjenerali.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Tjetër, Arben Isaraj kalon. Arben Xhiku kalon.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, Arben Isaraj nuk ka pengesë nga ana ligjore?

**Merita Qato** – Jo.

**Damian Gjikhuri** – Arben Xhiku nuk ka pengesë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, more, e kaluam atë sipër; e hoqëm, edhe Albi Gjeneralin e hoqëm...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vazhdojmë, numri...

*(Diskutime në sallë)*



Ares Çela, nuk ka pengesë, kalon. Artan Kodheli, është shkarkuar, nuk do ta marrim. Artan Kodhelin, hiqe. Anjeza Dajzmaili, nuk ka paraqitur... edhe kjo do pyetet.

**Merita Qato** - Anjeza Dajzmaili e kemi s'kualifikuar, sepse nuk ka eksperiencë, ka qenë vetëm eksperte.

**Damian Gjikhuri** –Behar Zeneli i kalon, se ka qenë edhe...

Besnik Maho, ish-gjyqtar, edhe ky kalon. Dritan Çaka, në rregull. Durim Grabova...

**Merita Qato** – Është pensionist sipas CV-së.

**Damian Gjikhuri** – Eldrina Karafili, nuk kalon, e thamë. Elvin Lako, ish-funksionar, ish- nënpunës, po kalon...Elvis Çefa, në rregull.

**Merita Qato** – Emiljano Braho këtu mund të kalojë, se është avokat.

**Damian Gjikhuri** – Esmir Rringaj, avokat aktualisht, ky do të pyetet.

*(Diskutim në sallë në pa mikrofon).*

Ah, te vetingu i policisë,

**Myslim Murrizi** – E mbaj mend, se ka qenë këtu.

**Damian Gjikhuri** – Ky është te vetingu i policisë.

**Merita Qato** – Jo, pra nuk e hoqëm.

**Damian Gjikhuri** – Fahrie Osmani është në rregull, duhet të thërritet vetëm për deklarinimin. Fatmir Tafaj, ish-nëpunës, nuk ka deklarinim, edhe ky duhet të thërritet, në rregull. Florian Beqaraj, edhe ky për deklaratë. Çfarë është ky?

**Merita Qato** – Avokat është, ka punuar avokat dhe vazhdon avokat.

**Damian Gjikhuri** – Hysen Osmanaj, në rregull. Ilir Rusmali në rregull. Irena Nino, kryesekretare, në rregull. Ismail Tafani në rregull. Iva Nathanaili...

**Merita Qato** – Iva Nathanaili, nuk e pranuar, e s'kualifikuar.

**Damian Gjikhuri** – Ivën e s'kualifikuar?

**Merita Qato** – Po.

**Damian Gjikhuri** – Ishte vetëm për Rregullatorin, prit një minutë.

**Merita Qato** – Iva Nathanaili është vetëm pedagoge dhe avokate, kështu që kalon, vetëm për këtë pozicion.

**Damian Gjikhuri** – Kjo është në rregull vetëm për këtë pozicion.

**Merita Qato** – Po, e shënuam. Kamerion Salillarini e s'kualifikuar, se nuk kishte asgjë, megjithëse kishte ushtruar profesionin e avokatit.

**Damian Gjikhuri** – Ka eksperiencë 3-vjeçare për gjykim administrativ? Ka punuar 3 vjet avokat?

**Merita Qato** – Ka qenë avokat më përpara, por nuk është tani.

*(Diskutim në sallë në pa mikrofon.)*

**Damian Gjikhuri** – Shihe kështu Merita, nëse ka eksperiencë, do ta kualifikosh, nëse jo... Në rregull?

Dakord, me kushtin që e verifikon Merita.

**Merita Qato** – Dakord, po e shikoj unë.

**Damian Gjikhuri** – Koli Bele, në rregull. Laureta Bregasi, edhe kjo do pyetet për këtë saktësimin. Lealba Pelling, në rregull. Ledio Braho, në rregull. Lefteri Luzi Lleshi, në rregull. Leonard Gremshi, në rregull, duhet pyetur. Edhe Lindita Tako për pyetje.

**Merita Qato** – Ka qenë avokate për 2 vjet.

**Damian Gjikhuri** – Më fal, ka eksperiencë në administratën shtetërore, gjykim administrativ, në rregull është, se po që kanë përfaqësuar ministrinë nëpër gjyqe, pra në rregull është.

Leonard Gremshi kaloi me kushtin që do të sqarohet.

Lindita Tako kaloi.

Mimoza Cenaj nuk ka vetëdeklarim, pra edhe kjo do të pyetet.

Muharrem Çakaj në rregull.

Naim Mëçallën ia kemi lënë Myslimit.

Odeta Seferaj është në rregull me pyetjet.

Pavlina Docaj çfarë kishte?!

**Merita Qato** – Pavlina Docaj e hoqëm, sepse ka punuar vetëm në studio, nuk ka punuar si avokate, pra nuk e ka ushtruar profesionin e avokates, por thjesht si përfaqësuese ligjore në këto organizata.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Damian Gjikhuri** – Është përfaqësuese ligjore, ka firmosur për letrat e kompanisë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Përparim Shullazi anëtar partie ikën.

Petrit Çano, drejtues i prokurorisë, do të pyetet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

E ka kaluar vetingun?

**Merita Qato** – Petrit Çano është në detyrë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Damian Gjikhuri** – Është prokuror i rrethit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Redinela Beqiraj është në rregull dhe është vetëm për pyetje.

**Merita Qato** – Problemi është Petrit Çano, sepse është akoma në detyrë si prokuror dhe nuk ka dhënë dorëheqjen.

**Damian Gjikhuri** – Nuk ka problem.

**Merita Qato** – E ndalon ligji i tyre.

Thotë nga radhët e ish-gjyqtarëve.

**Damian Gjikhuri** – Thotë ish-gjyqtar, nuk thotë ish-prokuror.

**Merita Qato** – Ai është në punë.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Damian Gjikhuri** – Ligji thotë “ish-gjyqtar”. Ky nuk është gjyqtar, është prokuror. Këtu pyetja shtrohet: a mundet një prokuror në detyrë të aplikojë? Unë mendoj se nuk ndalohet.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Atij nuk i lejohet edhe po të jetë prokuror.

**Merita Qato** – Nuk i lejohet të kandidojë, sepse është në detyrë, është në funksion. Po të thotë “ish”, thotë ish-funksionar, tregon edhe puna.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Damian Gjikhuri** – Nuk është ashtu: ligji e ka përcaktuar ish-gjyqtar, por ti mund të jesh në një pozicion shteti, sepse ke mospajtueshmëri. Për shembull, unë mund të jem drejtor në një institucion që varet nga ekzekutivi, sepse ligji e ka thënë. Unë jam ish-nëpunës i lartë, e plotësoj kushtin e parë, jam drejtor ekzekutiv, nuk jam më nëpunësi i lartë, por jam drejtor diku në një institucion shteti. Për shembull, drejtor Juridik i Ministrisë së Infrastrukturës dhe aplikon, pra ke mospajtueshmërinë për ushtrimin e detyrës. Domethënë, në momentin që ai fillon të zgjidhet komisioner, heq dorë nga detyra e drejtorit, sepse atij nuk i lejohet ta bëjë këtë punë. Unë them nuk ka pengesë për këtë gjë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Nuk ke pengesë, lexoje në ligj.

**Merita Qato** – Pika 2 thotë: “Kanë të drejtë të kandidojnë ose propozohen për anëtarë të KAS-it shtetas shqiptarë që vijnë nga radhët e ish-gjyqtarëve, ish- këshilltarëve në Gjykatën Kushtetuese ose në Gjykatën e Lartë, ish-anëtarve të KQZ-së, e ish-nëpunësve të nivelit të lartë drejtues ose e juristëve në profesion të lirë me përvojë në gjykimin administrativ.” Kaq thotë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** - Hajde të marrim një vendim.

Spiro Maliqi kalon se është avokat. Theodhori Sollaku dakord.

**Merita Qato-** Ata që nuk kalojnë janë Agim Pakali, Albi Gjenerali, Arben Gjiku (do e pyesim), Artan Kodheli, Anjeza Dajzmal, Drin Grabova, Eldrina Karafili, Naim Mecalla, Rudin Deda, Përparim Shullazi, Pavlina dhe Xhafer Seiti.

**Damian Gjikhuri** – Pas kësaj mbledhjeje do të bëni njoftimin dhe raportin dhe do t'ua dorëzosh të gjithë anëtarëve të këtij komisioni.

Pjesa e thirrjes do të bëhet pas orës dy, sepse ka edhe komision ligjesh. Mbledhja do të fillojë në orën 17:00 dhe i ndajmë në dy grupe. Grupi i parë do jenë komisionerët dhe nën komisionerët, pastaj rregullatorë.

Mbledhjen do ta bëjmë te salla e madhe dhe do të jetë fizikisht.

Proces me media prezent dhe jo më shumë se 5 minuta. Nëse ndonjëri nga pjesëmarrësit nuk e ka të mundur të paraqitet nesër, atëherë, mund të vazhdojë pasnesër. Takimi do të jetë 17:00- 20:00. A jeni dakord? Dakord.

## **MBYLLET MBLEDHJA**